

ETHICS AND DEMOCRACY IN GLOBALISM

Kujtim Kasami

Skopje, N. Macedonia, kujtimkasami@gmail.com

Abstract: While talking about the relationship between democracy and ethics, it is important to be mentioned that the term democracy itself, is one of the most used terms, especially in the field of social sciences. Thus, there are a lot of definitions about democracy, that are supposed to be in accordance with the principles of the modern science. Democracy is a symbol of value of many societies in the world, so every state proclaims its system as democratic, and most probably can be concluded that every state wants to have this epithet. The word 'democracy' is referred to the Greek words "demos", and "krateon", which means the 'rule of people', political regulation in which rule belongs to the people, the state in which the people are in governance through their representatives, the deputies. In the modern philosophy it is usual talking about the morality of politics, and some serious thinkers pretend that there is no such a thing like "practice of morality" and "the hands should be touched with mud", whereas morality has the ideal purpose.

The book "The Prince" of Niccolo Machiavelli(Niccolò Machiavelli, 1532), that has served as inspiration for many rulers, the content of which has been taken out of context for many tyrants. Machiavelli hoped to create a revolution in the hearts of his readers, and achieved it in a way. Only that in many cases, like in the case of a lot of dictators, not in the good way. Some of the wearers of his theories have only taken phases from the context, for example: "it is not important for a prince to have all of the mentioned attributes(merciful, loyal, human, honest and faithful), but it is important to look as he has them." Some of people inspired by this book are Stalin, Hitler, Mussolini... that have take out the moral out of politics. According to them, every method and tool is allowed to use for realising their goals, all of those methods are spread, and used by many dictators, tyrants and ruthless rulers. In the global world, seems that there is a tendency to bring back the spiritual element in the political processes and the development of democracy.

Keywords: Politics, ethics, democracy and globalism.

ETIKA DHE DEMOKRACIA NË GLOBALIZIM

Kujtim Kasami

Skopje, N. Macedonia, kujtimkasami@gmail.com

Abstrakt: Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet midis demokracisë dhe etikës, është e rëndësishme të theksohet se termi demokraci në vetvete është një nga termat më të përdorur gjerësisht në fushën e shkencave sociale. Kështu, për demokracinë ka shumë përkufizime për të cilat supozohet se ato janë në përputhje me parimet e shkencës moderne. Demokracia është simbol i vlerës në shumë shoqëri në botë, kështu që çdo shtet e proklamon sistemin e tij si demokratik, dhe me shumë probabilitet mund të konkludojmë se çdo shtet dëshiron ta ketë këtë epitete. Fjala demokraci i referohet fjalës greke "demos" dhe "krateon", që do të thotë sundimi i popullit, rendi politik në të cilin pushteti i përket popullit, shteti në të cilin populli është në qeverisje nëpërmjet përfaqësuesëve të tij, deputetëve. Në filozofinë moderne është e zakonshme të flasësh për moralin e politikës dhe disa mendimtarë seriozë pretendojnë se nuk ekziston diçka e tillë si "praktikë e moralit" dhe se "duart duhet të preken me baltë", ndërsa morali ka qëllimin ideal. Vepra "Sundimtari" i Nikolo Makiavelit (Niccolò Machiavelli, 1532) që ka shërbyer si frymëzim për shumë pushtetmbajtës, përmbajtka e së cilës ka qenë e nxjerrë jashtë kontekstit për shumë tiranë. Machiavelli shpresonte të krijonte një revolucion në zemrat e lexuesve të tij dhe ai e arriti atë në njëfarë mënyre. Vetëm se në shumë raste, siç është rasti i shumë diktatorëve, jo në mënyrën më të mirë. Disa prej aplikuesve të teorive të tij kanë marrë fraza të shkëputura nga konteksti, si për shembull: "...nuk është e nevojshme që një princ të ketë të gjitha cilësitë e lartpërmendura (i mëshirshëm, besnik, human, i ndershëm dhe besimtar), por është e nevojshme që të duket se i ka ato. Disa prej njerëzve të frymëzuar nga ky libër janë Stalini, Hitleri, Musolini etj... të cilët e kanë përjashtuar "moralin" nga politika.

Sipas tyre çdo metodë dhe mjet është i lejuar për realizimin e qëllimeve të tyre, të gjitha këto janë makineri të përhapura, të cilat i ndjekin shumë diktatorë, tiranë dhe sundimtarë të pamëshirshëm.

Në botën globale duket se ka një tendencë për të kthyer përsëri elementin "shpirtëror" në proceset politike dhe në zhvillimin e demokracisë.

Fjalët kyçe: Politika, etika, demokracia dhe globalizimi

1. POLITIKA

Nga fillimi i saj deri më sot, "politika" nuk ka pushuar së qeni subjekt i interesit dhe kërkimit të hulumtimeve. Teoria se shoqëria është një mjedis natyror për njeriun, d.m.th se njeriu është nga natyra një qenie shoqërore, u zhvillua së pari në mënyrë sistematike nga Aristoteli.²⁰ Sot, kur njeriu si individ dhe shoqëria kalojnë kriza të ndryshme, konceptimi politik dhe etik i Aristotelit, i cili thekson kufijtë natyrorë të njeriut si kufizime që njeriu nuk duhet të thyejë nëse dëshiron të mbetet njerëzor, tingëllon i freskët dhe frymëzues. Në kërkim të origjinës etimologjike të termit politikë, jemi të pashmangshëm drejtuar drejt situatës kohore dhe historike në të cilën kalimi nga ontologjia kozmologjike para-Sokratike dhe bota e tij shoqërore në Greqinë antike klasike u ndërmjetësua nga retorika, duke e theksuar atë që në fillim, shpesh me një rëndësi të veçantë, politika dhe filozofia politike si një fushë në të cilën teoria dhe praktika takohen dhe bashkohen, pra format më të larta të njohurive dhe veprimeve njerëzore. Termi është shumë i gjerë dhe përfshin të gjitha format e qeverisjes së veprimtarive të pavarura. Kështu flitet shumë për politikën e këmbimit valutor të bankave, për politikën e një lidhje sindikale gjatë një greve, po flasim gjithashtu për politikën e një shkollë në një fshat apo qytet, politikën e një drejtimi të një kompanie dhe politikën e një grua inteligjente që "drejton" burrin atje ku dëshiron dhe si dëshiron. Një përmbajtje konceptuale, kaq e gjerë e politikës, ne nuk duam ta shfaqësojmë sot, por me politikën duam të nënkuptojmë vetëm: leadership ose ndikim në udhëheqjen e një formacioni politik, që do të thotë në rrethanat tona: të një shteti (Weber, 2009). Ndër shumë nocione të ndryshme të politikës, një është tradicional dhe pothuajse klasik. Ai e lidh politikën me shtetin dhe rregullin e tij. Politika është një veprimtari e shtetit, dhe konsiston në ekzekutimin e rregullit të tij, kryesisht përmes miratimit dhe zbatimit të ligjeve (Hristova & Mirchev, 2008). "Politika nuk është një shkencë ... por një aftësi", thotë Kancelari Bismark përpara Reichstag-ut të Gjermanisë. Aftësia që Bismark flet është aftësi e qeverisjes, e ushtrimit të kontrollit mbi shoqërinë duke marrë dhe zbatuar vendime kolektive. Fjala politikë vjen nga fjala polis, që fjalë për fjalë do të thotë qytet-shtet (Haywood, 2009). Politika është një veprimtari përmes së cilës njerëzit krijojnë, ushqejnë dhe plotësojnë rregullat e përgjithshme me të cilat ata jetojnë. Nga ky këndvështrim, politika mund të kuptohet si një veprimtari që drejton, rregullon dhe përcakton marrëdhëniet midis anëtarëve të polisit, ose, me fjalë të tjera, ajo që zbatohet për polisën (i cili është shqetësimi i saj) është ajo që i referohet shtetit (Heywood, 1994). Në thelb, ajo nënkupton një veprimtari shoqërore, e cila është e lidhur në mënyrë të pandashme me ekzistencën e dallimeve dhe konflikteve, nga njëra anë, dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe vepruar kolektivisht, nga ana tjetër. Politika shihet më shumë si kërkim i zgjidhjeve për konfliktet sesa si mënyrë për t'i arritur ato. Politika kuptohet ndryshe nga mendimtarë të ndryshëm dhe në tradita të ndryshme.²¹ Qasje të ndryshme janë miratuar në studimin e politikës si një disiplinë shkencore. Këto përfshijnë filozofinë politike, gjegjësisht analizën e teorisë normative, traditën empirike që merret posaçërisht me studimin e institucioneve dhe strukturave, përpjekjen për të prezantuar precizitetin shkencor përmes analizave të sjelljes dhe variantet e shumta të qasjeve moderne, përfshirë këtu zbatimin e zgjedhjes racionale. Studimi i politikës është shkencërisht në atë masë sa na lejon të fitojmë njohuri objektive të botës politike duke bërë dallimin midis fakteve dhe vlerave. Ekzistojnë dy mënyra për të udhëhequr politikën. Ose: ju jetoni "për" politikë - ose: ju jetoni "nga" politika. Në parim, njerëzit, më pak nga ideali dhe më shumë për përfitim material, i praktikojnë të dyja (Weber, 2009).

2. ETIKA

Etika është një lloj i veçantë veprimi, i rrënjësor në vlera dhe parime morale, duke shprehur atë që është e mirë dhe e drejtë - vlera dhe virtyte siç janë drejtësia, dhembshuria, ndershmëria, besnikëria dhe madje edhe moda e vjetër (traditat), siç është përulja, modestia dhe mendimi. Etika është veprim, të cilin Ju mund ta mbronit publikisht dhe lehtë dhe veprim që do të ishte diçka, me të cilën ju dhe komuniteti juaj do të dini se si të vepronit. Etika është një mendim i plotë, i vazhdueshëm dhe argumentues për të jetuarit e mirë dhe sjelljen e duhur (Čekoh & Koprek, 1996). Fjala etikë vjen nga fjala greke etos që do të thotë traditë, karakter ose moral. Etika është shkencë që studion moralin. Çdo gjë që është etike, jo gjithmonë shkruhet me ligj shoqëror. Etika është një shkencë që synon të ndihmojë njerëzit të formojnë karakterin e tyre. Ajo përmban rregulla ose ligje që u shërbejnë njerëzve të sillen siç

²⁰ Shihni: Aristoteli, Politika, (Përkthim nga origjinali, komenti, shënimet dhe fjalët e urta: Margarita Buzalkovska-Aleksova dhe Elena Dzukëska), Slovo, Shkup, 2006.

- "politika" e Aristotelit ishte frymëzimi për Kickeron, për juristët bizantinë dhe mesjetarë. Komente nga Alberti i Madh, redaktuar nga Thomas Aquinas, Cilësimet themelore të kësaj vepre ishin pikënisja për Machiavelli, Erasmus, Hobbes, Spinoza, Locke, Montesquieu, Rousseau. "Politika" është akoma e rëndësishme edhe sot, për shkak të ideve të Aristotelit, të cilat në kohën tonë tingëllojnë po aq të freskëta siç bënë dy mijë vjet më parë.

²¹ Në librin e tij Politika, E. Haywood, një nga shkencëtarët më të cituar politikë bashkëkohorë, do të tregojë katër kuptime më të zakonshme të politikës: 1) Politika si aftësi e qeverisjes; 2) Politika si veprimtari publike; 3) Politika si kompromis dhe konsensus; dhe 4) Politika si shpërndarje e fuqisë dhe burimeve. - Andrew Haywood, Politika, Akademski pečat, Shkup, 2009, fq.5-13.

duhet në familje, në shkollë, në natyrë, në shoqëri, në politikë dhe kudo në përgjithësi. Etika dhe morali i referohen sjelljes "të drejtë" dhe "të gabuar". Etika dhe standardet etike janë një përbërës i rëndësishëm në përcaktimin dhe formulimin e përgjithshëm të politikave, si dhe një pikë referimi për vlerësimin parësor dhe themelor në veprimin politik. Nëse premisa themelore e etikës është të bësh mirë dhe të shmangësh të keqen, në shikim të parë çështja e etikës në këtë fushë mund të duket ambivalente, dhe madje në disa aspekte iluzore. Është një perceptim i përgjithshëm pothuajse gjithmonë kur mendojmë për politikën dhe për jetën politike në kuptimin e ngushtë të fjalës, kur bëjmë një shoqatë/asociacion ose një përfaqësim të mbajtësve të funksioneve publike ose kur flasim për marrëdhëniet e përditshme në shpërndarjen e fuqisë së një ligjërimi teorik. Këtu janë disa pyetje themelore që ne do të përpiqemi t'u përgjigjemi. Së pari, si dhe në çfarë mase duhet trajtuar etikën në jetën politike, domethënë, si e parashikon vendimmarrja politike, qytetaria dhe teoria. Së dyti, a mund të përcaktojmë një kornizë themelore të drejtimeve moderne në veprimin politik të mbështetur në etikë dhe parime morale, dhe së fundi, çfarë duhet të konsiderojmë, d.m.th. cilat qasje janë në dispozicion për ne në një vlerësim të tillë. Etika është një lloj i veçantë i ekzistencës shoqërore njerëzore në të cilën kapacitetet e saj aksiologjike veprojnë për të dalluar dhe vendosur të mirën dhe të keqen. Ajo zbulon dhe përfaqëson kuptimin e jetës, e cila është shumë e rëndësishme për njeriun për vetëvendosje, ndërtimin e komunitetit dhe veprimin në të gjitha fushat (Temkov, 2007). Etika është mbi të gjitha udhëzuesi bazë që përcakton kuptimin e sjelljes njerëzore nga një këndvështrim humanist, në marrëdhënie me njerëzit e tjerë, në dritën e asaj që është e mirë dhe ajo që është e keqe. Njeriu është qenie shoqërore, sepse, siç thotë Aristoteli, ata që nuk jetojnë në një bashkësi janë ose kafshë ose perëndi, kështu është e domosdoshme që njerëzit të imitojnë modelet e sjelljes së duhur dhe morale në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella. Në anën tjetër politika kuptohet si një fushë në të cilën vendosen punët e përbashkëta në sferën publike të jetës, bëhet shpërndarja e pushtetit dhe respektimit të personave qeveritar - qeverisur, dhe kështu në mënyrë implicite e përcakton problemin e qasjes dhe natyrën e parimeve etike në atë fushë të pushtetit. Nëse abstraktojmë momentalisht çështjen e karakterit të pushtetit dhe natyrën e nënshtrimit dhe përqendrimit në shoqërinë moderne demokratike, atëherë është e qartë që etika zë një vend të rëndësishëm në demokracitë moderne, me theks të veçantë postmoderne, duke pasur parasysh vlerën e një kategorie të tillë - të drejtat e njeriut dhe liritë, barazia, drejtësia, solidariteti, dinjiteti, etj. Të gjitha këto janë koncepte që detyrimisht tërheqin dhe përmbajnë një dimension etik. Këto janë terma që përshkojnë pothuajse të gjitha sferat e ligjëritit publik dhe aspektet e ndërthurura në të gjitha momentet e njësisë politike. Nëse shkojmë më thellë edhe në të gjitha fazat e ekzistencës njerëzore, nga gjendja natyrore deri në formimin e shoqërisë dhe pastaj të shtetit (ta themi me fjalorin e Llokut)), përmes monarkive absolute, revolucioneve të ndryshme, deri në themelin modern demokratik dhe formimin e bashkësive politike në botën perëndimore gjithmonë dhe kudo parimet etike, morali ka qenë dhe mbetet ai drejtim i veprimit ose një moment legjitimitimi i rendit dhe fuqisë. Urdhri nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë tjetër, duke u nisur nga fakti se veprimi kolektiv dhe ligji i përgjithshëm domosdoshmërisht justifikojnë ose synojnë të mirën, njeriun, dhe bëjnë përpjekje (ose përpiqen ta paraqesin veten si të tillë) për të shmangur të keqen. Si rezultat, theksohet se politika është e lidhur domosdoshmërisht me etikën dhe dimensionin etik në tendencën e saj fillestare dhe kërkon në mënyrë racionale të bëjë dallim midis asaj që është e mirë ose e keqe për komunitetin dhe njerëzit.

3. SJELLJA ETIKE

Njerëzit si individë mund të jenë moral, sepse ata kanë aftësinë të marrin parasysh interesat e njerëzve të tjerë (Maleski, 2012). Në mënyrë që të realizohet morali dhe sjellja morale, nevojiten parakushte që janë në thelb themelet e moralit. Fenomene të ndryshme në natyrë kanë qëllimin e tyre, dhe shkenca e di se ato drejtohen dhe qeverisen nga ligje të caktuara. Shkencëtarët e të gjitha disiplinave shkencore në të kaluarën u kanë kushtuar shumë kohë, si dhe mjete materiale, për të zbuluar dhe shpjeguar ato ligje të natyrës. Zbulimet e ligjeve individuale dhe shpjegimet e realizuara janë integruar në njëra-tjetrën, të sistematizuara dhe të shkruara i jepen njerëzimit për zbatim praktik, por edhe për studime të mëtejshme. Njohuria, në vetvete, se çdo fenomen në natyrë ka një qëllim specifik dhe se qeveriset saktësisht nga ligje të caktuara, jep baza reale për studime të mëtejshme jo vetëm të vlerave të përgjithshme, por edhe të moralit. Njohuritë shkencore, se çdo krijesë sillet sipas rregullave të caktuara dhe parimeve të caktuara, janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Arthur Schopenhauer (Arthur Schopenhauer) etikës i përcakton nevojën morale objektive për të shpjeguar dhe interpretuar sjelljet e ndryshme të njerëzimit dhe për të zvogëluar në themelin e tyre përfundimtar. Prandaj, nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të gjetur bazën e etikës sesa të hulumtojmë në mënyrë empirike nëse ka ndonjë veprim në të cilin duhet të pranojmë vlera të vërteta morale, të cilat do të jenë akte të drejtësisë vullnetare (Schopenhauer, 1998), filantropi të pastër dhe mirënjohje të vërtetë. Në epokën e sotme, edukimi etik i individëve përgjegjës autonom është një nga detyrat më thelbësore të njerëzimit për të zgjidhur problemet me natyrën, konfliktet njerëzore, mosinteresimin në mjedis dhe njerëzit që janë burimi i kërcënimeve negative për racën njerëzore, duke degraduar humanizmin dhe shkatërruar potencialet e nevojshme natyrore. Gjatë shekujve, edukimi moral ka dhënë supozimin se morali është i lindur te njeriu, jo rezultat i

marrëdhënieve reale në shoqëri, por një forcë që krijon ato marrëdhënie, dhe që nga fëmijëria kanë qenë të ndara në të mira dhe të këqija nga natyra. Sidoqoftë, "orientimi më i rëndësishëm etik në historinë njerëzore është ai që rekomandon që të matet gjithçka". Kuptimi ynë për moralin buron nga praktika shoqërore dhe presupozon zhvillimin e vazhdueshëm të shkencave shoqërore, si pasojë e ndryshimit shoqëror dhe thekson nevojën për vlerësim të vazhdueshëm dhe të rivlerësimit të vlerave, me qëllim ndryshimin e pozitës së njeriut në botë dhe në shoqëri. Normat morale po ndryshojnë, megjithëse ekzistojnë në çdo shoqëri, dhe kjo tregon se burimi i sensit moral është qenia shoqërore e njeriut dhe shpreh nevojat e tanishme shoqërore dhe jetësore (Temkov, 1998). Ne e kuptojmë këtë më mirë kur lexojmë vepra me ide filozofike rreth sjelljes etike.²² Filozofët e mëdhenj dhe figurat shpirtërore përgjatë historisë kanë theksuar funksionin fisnik të edukimit, por një përmbledhje e ideve të mendimtarëve më të rëndësishëm për këtë çështje, që nga lashtësia e deri më sot, tregon unitetin e pozitave të tyre shpirtërore dhe se si mësimet e tyre pasuruan doktrinën etike (Vukasović, 1974).

4. PËRKUFIZIMI DHE KONCEPTET RRETH GLOBALIZIMIT

Kur flasim për globalizimin, kemi parysh se flasim dhe bisedojmë për një proces, në një kohë kur vlon me nocione, koncepte dhe mendime të ndryshme rreth situatave dhe ndodhive të ndryshme të cilat janë të shumta por gjithësesi kërkojnë elaborim dhe studim në kohë dhe trajtim objektiv.

Në kuptimin e ngushtë të fjalës, me nocionin globalizim nënkuptojmë shndërrimin e ekonomive nacionale në ekonominë globale botërore. Kjo praktikisht do të thotë se procesi i globalizimit ka lindur dhe është zhvilluar nga procesi i afarizimit me një ideologji afariste.

Sipas Clintonit, globalizimi nuk është diçka që ne mundemi ta zbrapsim ose ta shuajmë. Ai është një ekuivalent ekonomik i forcës së natyrës siç është era dhe uji, ne nuk mundemi ta injorojmë atë- dhe ai nuk do të largohet²³.

Globalizimi është proces që ka përfshirë gjithë globin dhe në të gjitha sferat ndërtuese.

Esenca e globalizimit mund të shpjegohet edhe nëpërmjet rastit të princeshës Diana. Ajo ishte angleze dhe miku i saj egjiptian humbën jetën në një tunel francez, derisa po udhëtonin me një veturë gjermane, me motor holandez, me shofer belg, e po ndiqeshin këmba këmbës nga paparacët italianë, të hipur në motorë japonezë. Në bazë të kësaj ngjarje, mund të shpjegohet esenca e sintezës të procesit të globalizimit²⁴.

Ç'është e vërteta, ekzistojnë shumë përkufizime (definicione) për atë se ç'është në të vërtetë globalizimi dhe lirisht mund të thuhet se këto përkufizime në të shumtën e rasteve janë tepër subjektive dhe varen nga përvoja dhe pozita e përkufizuesit, nëse ai ka mendime e qëndrime pro ose anti-globaliste.

Sipas **Anthony Giddens** „Globalizimi është intensifikimi i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore, përmes të cilave vende të largëta mbajnë lidhje me njëra tjetrën, në mënyrë të tillë që ngjarjet në një vend karakterizohen nga të njëjtat procese sikurse edhe në një vend tjetër shumë kilometra larg, dhe anasjelltas...“²⁵ Ekzistojnë diskutime të shumta akademike rreth asaj nëse globalizimi është një fenomen i vërtetë apo vetëm një artefakt (mit) analitik. Edhe pse termi në fjalë është mjaft i përhapur, shumë autorë thonë se karakteristikat që i vishen globalizimit sot janë vërejtur edhe më herët në kohë të ndryshme të historisë. Dimensionin ekonomik i globalizimit ka padyshim një rëndësi tepër të madhe dhe përbën një shkak dhe forcë të rëndësishme lëvizëse për proceset e globalizimit në fusha të tjera.

Kështu, globalizimi sot përfaqëson një dukuri të paevitueshme në historinë e njerëzimit, që po e bën botën gjithnjë e më të vogël nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të mallrave, shërbimeve, informacionit, njohurive dhe kulturave midis vendeve të ndryshme. Gjithashtu, paradigma e globalizimit paraqitet si dukuri gjithëpërfshirëse, pasojat e së cilës janë të ndryshme në të gjitha vendet, si në ato të zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim e sipër²⁶.

5. FORMAT E GLOBALIZIMIT

Globalizimi mund të thuhet se është një proces që prek të gjitha fushat e jetës së njeriut. Është identifikuar me një numër prirjesh, që përfshijnë një lëvizje më të madhe ndërkombëtare të të mirave, të parave, të informatave e të njerëzve, si dhe përfshijnë zhvillimin e teknologjise, organizatave, të sistemeve juridike e të infrastrukturës

²² Në mësimin e tij mbi moralin, filozofi dhe sociologu i madh Emil Durkheim veçon tre elementë të moralit: 1) shpirtin e disiplinës, 2) besnikërinë, lidhjen me grupet shoqërore dhe 3) autonominë e vullnetit. Shihni: Dr Mimir Ivković: Vaspitanje i društvo. Dirkemova sociološka teorija vaspitanja, Gradina, Niš, f. 172.

²³ Selmanaj, S. (2014). Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit. Prishtinë, fq.81.

²⁴ Civici, A. (2009). Globalizimi. Tiranë, fq.17.

²⁵ Kasami, K. (2015). Ndryshimet shoqërore dhe globalizimi. (Dispencë). Kërçovë, fq.4.

²⁶ Polisi, F. dhe Musliu, A. (2015). Sociologjia e së drejtës. Vatra. Shkup, fq.191.

që e lejojnë dhe mundësojnë një lëvizje të tillë. Do të përmendim veçoritë kryesore të këtij procesi të manifestuar në jetën ekonomike, kulturore, juridike e teknologjike²⁷. Veçoritë kryesore të këtij procesi kryesisht janë të manifestuara në jetën ekonomike, kulturore, juridike e teknologjike. Edhe Beck dhe shumica e autorëve janë të pëlqimit se globalizimi është një proces ekonomik, social, kulturor, politik dhe juridik që i tejkalon kufijtë shtetëror nacional²⁸.

Në vazhdim do të përmend veçoritë kryesore të këtij procesi të manifestuar në jetën ekonomike, kulturore, juridike e teknologjike.

1. Në nivelin *ekonomik* globalizimi shfaqet në:

- rritjen e tregtisë ndërkombëtare në një shkallë shumë më të shpejtë sesa rritja e ekonomisë botërore;
- shtimin e rrjedhjes ndërkombëtare të kapitalit përfshirë edhe investimet e jashtme direkte;
- lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë shkaktuar krijimin e organizatave si WTO (Organizata Botërore e Tregtisë) dhe të karteleve ekonomike siç është OPEC;
- zhvillimin e sistemeve globale financiare;
- rritjen e rolit të organizatave ndërkombëtare siç janë WTO, WIPO...që merren me transaksione ndërkombëtare;
- shtimin e praktikave ekonomike (përdorimi i burimeve të jashtme) dhe zhvendosje e proceseve të biznesit nga një vend në tjetrin nga korporatat multinacionale...²⁹

2. Në nivelin *kulturor* globalizimi shfaqet në:

- shkëmbimin kulturor gjithnjë më të madh ndërkombëtar;
- përhapjen e multikulturalizmit si dhe pranimin më të mirë individual në shumëllojshmërinë kulturore, për shembull përmes eksportimit të filmave të Hollywoodit e të Bollywoodit. Megjithatë, kultura e importuar lehtë mund t'ia zërë vendin kulturës lokale duke shkaktuar me këtë rast reduktimin e shumëllojshmërisë përmes hibridizimit ose madje edhe përmes asimilimit. Forma më e spikatur e kësaj është westernizimi (perëndimizimi), mirëpo gjithashtu ndodh edhe sinicizimi ose sinifikimi (asimilimi gjuhësor apo kulturor i termave dhe koncepteve në gjuhën apo kulturën kineze);
- udhëtimin dhe turizmin gjithnjë më të madh ndërkombëtar;
- imigrimin më të madh, përfshirë edhe imigrimin ilegal;
- shtrirjen e prodhimeve të gatshme lokale (p.sh. ushqimit) në vende të tjera (shpesh të adaptuara ndaj kulturës së atyre vendeve);
- modat (trillet) botërore dhe në kulturat (popullore) siç janë: idole, YouTube, My Space, Messenger dhe shumë të tjera;
- ngjarjet botërore të sportit siç është Kupa Botërore e FIFA-s (Federata Ndërkombëtare e Futbollit) dhe lojërat olimpike;
- formimin ose zhvillimin e një sërë vlerash universale...³⁰

3. Në nivelin *teknik / juridik* globalizimi manifestohet në:

- zhvillimin e një infrastrukture globale për telekomunikim dhe në rrjedhjen më të madhe të të dhënave përtej kufirit, duke përdorë teknologjinë si internetin, satelitët për komunikim, fijet optike të nëndetëseve dhe telefonat celularë;
- shtimin e numrit të standardeve të zbatuara në shkallë globale, p.sh. ligjet për të drejtat e autorit (copyright laws) dhe patentat;
- iniciativën e shumë avokatëve për themelimin e gjykatave ndërkombëtare për krime lufte dhe lëvizjeve ndërkombëtare për drejtësi, si për shembull kemi ICC – The International Criminal Court (Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Lufte) dhe ICJ – The International Court of Justice (Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi)...

Dimensionin politik i globalizimit shpeshherë përdoret si nocion kontrovers për të artikuluar interesat nacionale shtetërore. Në këndvështrimin të shkencave politike procesi i globalizimit paraqitet në tri forma të njëkohshme dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën, si:

- 1.Lindje e sistemit global politik;
- 2.Krijimi i shteteve të reja nacionale dhe
- 3.Partikularizimi regjional³¹.

²⁷ Kasami, K.(2015). Ndryshimet shoqërore dhe globalizimi. (Dispencë). Kërçovë, fq.10.

²⁸ Milardocić, A.(1999). Globalizacija. Panliber. Zagreb, fq.10.

²⁹ Shih më gjerësisht: Selmanaj, S. (2014). Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit. Prishtinë, fq.86-92.

³⁰ Pallazhçenko, P. 2004: Diallog kultur v jazikovom prostranstje mira, në Svobodnaja misl - XXI, №6.

³¹ Polisi, F. dhe Musliu, A.(2015). Sociologjia e së drejtës. Vatra. Shkup, fq.198.

6. PËRFUNDIM

Globalizimi nuk është i mirë, por nuk është as i keq. Të gjithë ata që vendosin veten në perspektivat Pro apo Kunder globalizimit, i shohin zhvillimet vetem në kontekstin e interesave personale apo kombëtare, jo në interesin global. Është e vërtetë që interesat ekonomike fitojnë një prioritet mbi interesat principore dhe çdo vlerë shoqërore barazohet me një vlerë financiare. "Në botë nuk do të ketë ndonjëherë paqe për aq kohë sa ka uri" - ka thënë Simon Perez, ish-kryeministri dhe ministri i jashtëm izraelit. A i interesojnë vlerat dhe principet një njeriu të uritur në Kinë, Indi, apo Afrikë?

Një prej efekteve tepër pozitive të globalizimit ka qenë zgjerimi i tregjeve lokale në një treg të përbashkët botëror. Kjo ka bërë që korporatat e mëdha perëndimore të lëvizin biznesin e tyre në vende si India dhe Kina që ofrojnë punëtorë në masë dhe kosto shumë të ulët pune krahasuar me koston në vendet e tyre. Kjo shikohet si një kërcënim për punëtorët amerikanë, gjermanë apo britanikë që humbin vendet e tyre të punës, por në të njëjtën kohë është një avantazh për të shuar urinë dhe krijuar një shtresë të mesme edhe në vendet më të populluara të botës si India dhe Kina me 1/2 të popullsisë së botës. A do të mund të shikonim këtë lulëzim marrëdhëniesh me Kinën komuniste, nëse nuk do të kishim politikën e globalizimit të ekonomisë midis SHBA dhe Kinës? A do të mund të mbijetonte stabiliteti politik e shoqëror në Kinë, nëse miliona kineze nuk do ta gjenin veten në punë e jo në rrugë pa asnjë të ardhur? E solla shembullin me Kinën për të provuar që zhvillimi ekonomik i shpejtë i saj, i ka hapur udhën krijimit të një shtrese të mesme dhe një shtresë të pasur biznesmenësh, që janë investimi më i madh i bërë për një Kinë demokratike në të ardhmen. Shqipëria si vend i vogël (në marrëdhëniet me FMN dhe BB) hyn në "detin global" si një varkë e pasigurtë, sepse vinte nga një ekonomi e asfiksuar nga mbyllja 50 - vjeqare teknologjike e profesionale. Mjaft politikanë thonë se e vetmja mënyrë konkurimi e Shqipërisë, pas viteve 90-të, u bë emigrimi dhe shitja e krahut të lirë të punës. Ngjarjet e vitit 97-të sollën momente tragjike pas shembjes së piramidave financiare. Globalizimi ka bërë të mundur që ekonomia amerikane të dyfishojë e trefishojë GDP e vete pasi ajo i ka rritur mushkëritë e saj me tregjet e reja të krijuara në vende si Kinë, Indi, Filipine, Meksikë. Kjo nuk do të thotë që prosperiteti amerikan ndahet nga pjesa tjetër e botës, por në të njëjtën kohë hapja e tregjeve të reja në botë ka krijuar zhvillimin e këtyre tregjeve dhe rritjen e vazhdueshme të mirëqenies në to. Sfidat e procesit të globalizimit mund të përmbledhen në këto pika.³²

1. Së pari, në vend të rritjes ekonomike, ka ndodhur rritja e varfërisë, me përjashtim të Kinës. Ky konstatim mund të argumentohet në bazë të këtij fakti: deri në 40% të popullatës botërore jetojnë në varfëri, afro 36% respektivisht 877 milionë njerëz jetojnë nën linjën e varfërisë absolute;
2. Së dyti, shteti-komb tradicional në epokën e globalizimit përballet me zvogëlimin e shtrirjes së autoritetit të tij në vend dhe në arenën ndërkombëtare;
3. Së treti, globalizimi na ka mundësuar që të jetojmë në lokalitete, por gjithmonë duhet të mendojmë globalisht dhe ta paramendojmë veten si pjesë të komunitetit global;
4. Së katërti, "problem themelor ekologjik në epokën e globalizimit është vështirësuar e ndërlikuar, larmia biologjike është në varfërim të shpejtë, po përkeqësohet cilësia e jetës së njeriut si pasojë e shtimit të faktorëve ndotës të mjedisit dhe të biosferës"³³;
5. Së pesti, "ndërvarësia e shteteve të botës u rrit jashtëzakonisht. Kjo ka dalë në pah lidhur me varësinë e ekonomive të shteteve në tregëtinë e tyre me njëri – tjetrin"³⁴.

LITERATURA

- Панцова, П. (2003). Наука како занает. Fakulteti Filozofik. Shkup
- Barber, B.R., & Kenny, C. (n.d.). "Why Are We Worried About Income?", në: www.sciencedirect.com
- Brooks, D. (n.d.) Good News about Poverty“, në: www.columbia.edu .
- Civici, A. (2009). Globalizimi, Ante portas, Tiranë.
- Civici, A. (2012). Globalizimi ... , botimi i dytë, Tiranë.
- Eko, U. (1997). Si bëhet një punim diploma. Botime Përpjekja. Tiranë
- Hide, E. (2009). "Globalizmi dhe anti-globalizmi", Marrë nga www.forumishqiptar.com/archire/index.php/html - parë për herë të fundit më datë 30 Mars 2009.
- IMF Staff, (2000). "Globalization: Threat or Opportunity?", në: www.imf.org .
- Kasami, K. (2015). Ndryshimet shoqërore dhe globalizimi. (Dispencë – Përmbledhje ligjeratash). Kërçovë

³² Në temën "Sfidat e procesit të globalizimit" prof. Selman Selmanaj në librin e tij: "Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit". Prishtinë (2014) sfidat në globalizim i ka përmbledhur në 10 pika, shih më gjerësishtë në fq.109-111.

³³ Pëllumbi, S (2009). Globalistika. Tiranë. fq.202.

³⁴ W. Phillips Shiveley. (2010). Hyrje në shkencat politike. Tiranë, fq. 506.

- KOF Konjunkturforschungsstelle: www.kof.ch/globalization
- Kurtishi, S. (2008). Globalizimi, Komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe, Prishtinë
- Milardocić, A. (1999). Globalizacija. Panliber.Zagreb
- Nye, J. (n.d.). „Globalism Versus Globalization“, në: www.theglobalist.com .
- Pajaziti, A. (2012). Ndryshimet Sociale dhe globalizimi, (Dispencë), Shkup
- Pallazhenko, P. (2004). Diallog kultur v jazikovom prostranstje mira, në Svobodnaja misl - XXI, №6
- Pfefferman, G. (n.d.). “The Eight Losers of Globalization”, në: www.theglobalist.com
- Polisi, F., & Musliu, A. (2015). Sociologjia e së drejtës. Shkup
- Revel, Ž.-F. (n.d.). “Antiglobalizam = Antiamerikanizam”, Marë nga:
http://www.katalaksija.com/v2.0/index.php?option=com_content&task=view&id=28&Itemid=4, parë për herë të fundit më datë 12 Prill 2009.
- Selmanaj, S. (2014). Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit. Prishtinë
- Servet Pëllumbi, S., (2009). Globalistika. Tiranë
- Shiveley, W. P. (2010). Hyrje në shkencat politike. Tiranë
- Steger, M.B. (2003). Globalizimi hyrje e shkurtrë, Ombra, Tiranë
http://www.dadalos.org/globalisierung_alb/grundkurs_5.htm
- <http://www.imf.org/>, IMF Staff
- <http://www.zeriislam.com/2008/Globalizmi-ne-dobi-apo-ne-dem-te-njeriut.html>, parë për herë të fundit më datë 12 Prill 2009.
- www.globalexchange.org/economy/rulemakers/TenWaysToDemocratize.html, parë për herë të fundit më datë 10 Prill 2009.